



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 14.02.2022, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 04.02.2022.
2. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC TERFOJA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tërfoje” me kapacitet të instaluar 1980 kW.
3. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC TERFOJA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
4. Mbi miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit.
5. Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021.
6. Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022.
7. Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a. për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr.104, datë 23.06.2016, të bordit të ERE, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE nr.49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013”.
8. Mbi shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kW dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kW, me kapacitet total të instaluar 14962 kW.